



Education and Culture DG

'Youth in Action' Programme

# Rrugët për bashkëpunim Ndërkombëtar në **fushën e rinisë**



## Eksplorimi i shtigjeve globale

Bota e sotme është një botë e globalizuar, ndaj rritja e bashkëpunimit ndërkombëtar është thelbësore për përbashkëtimin e sfidave të përbashkëta. Bashkimi Evropian si një lojtar global aktiv, i kushton një rëndësi të veçantë vendosjes së marrëdhënieve të mira me vendet jo anëtare në të gjitha fushat, me qëllim që të promovojë paqen, stabilitetin, sigurinë, të drejtat e njeriut, demokracinë dhe respektimin e ligjit përtej kufijve të tij.

Në këtë perspektivë globale, të rinjtë luajnë një rol vendimtar në ndërtimin e të ardhmes së BE-së dhe marrëdhënieve të saj me vendet fqinjë dhe pjesën tjetër të botës. Programi "Youth in Action" ("Rinia në Veprim") është ideuar për të nxitur tek të rinjtë ndjenjën e qytetarisë aktive dhe pjesëmarrjen në jetën demokratike si dhe rritjen e shpirtit të solidaritetit dhe të mirëkuptimit.

Perioda që përfshin ky program **2007-2013, ofron mundësi për lëvizshmërinë dhe edukimin joformal** me ndihmën e një sërë aktiviteteve, të tilla si shkëmbimet rinore, shërbimet vullnetare ndërkombëtare si

dhe trajnimet dhe organizimi i rrjeteve të bashkëpunimit mes punonjësve rinorë dhe organizatave rinore. Ky program, i krijuar pas konsultimeve të gjata me aktorë të ndryshëm në fushën e rinisë, synon të jetë një përgjigje e zhvillimeve në sektorin rinor në nivel evropian... por, për të qenë tërësisht i përshtatur ndaj realitetit të të rinjve të sotëm, ai nuk mund të kufizohet brenda kufijve të BE-së.

**Aksioni "Youth in the World (Rinia në Botë)" nxit një hapje më të madhe ndaj botës,** duke i dhënë programit një dimension më të madh ndërkombëtar. Ky aksion synon promovimin e bashkëpunimit mes të rinjve dhe organizatave rinore përtej kufijve të Bashkimit Evropian si një mjet që nxit dialogun ndërkulturor, solidaritetin dhe tolerancën dypalëshe, heqjen e paragjyqimeve dhe stereotipeve dhe ndërtimin e shoqërive me bazë mirëkuptimit dhe respektin reciprok. Ky aksion mbështet projekte bashkëpunimi me Vendet Partnere duke e vendosur vëmendjen në vendet e rajoneve fqinj, si Evropa Lindore dhe Kaukazi, rajoni i Mesdheut dhe Evropa

Juglindore.

**Komisioni ka ngritur tri qendra burimore të SALTO-s me qëllim që të promovojë Programin** dhe të ndihmojë promovuesit e projekteve në gjetjen e partnerëve dhe zhvillimin e aktiviteteve të cilësishme në fushat e lartpërmendura. Kjo broshurë, është realizuar me iniciativën e tyre dhe me qëllimin që t' u paraqesë të interesuarve tërësinë e mundësive që shpalos Programi "Youth in Action" përsa i përket bashkëpunimit ndërkombëtar. Lëreni veten të përfshihen nga ky rrugëtim, gjejini kohën të zbuloni mundësitë dhe sfidat e ndryshme që ai ofron, shijoni dëshmitë e promovuesve dhe përfituesve të projekteve të mëparshëm dhe frymëzohuni!

**Pascal LEJEUNE**  
Komisioni Evropian  
Drejtorja e Përgjithshme për  
Edukimin dhe Kulturën.  
Njësia rinore: Programet



# Procesi i Stabilizim – Pranimi në Evropën Juglindore

“E ardhmja e Ballkanit Perëndimor është brenda Bahkimit Evropian (...) Përgatitjet për integrimin në strukturat evropiane dhe anëtarësimi final në Bashkimin Evropian përmes përshtatjes së standardeve evropiane është sfida jonë e radhës”

*Samiti Ballkani Perëndimor-BE, Deklarata e Selanikut, qershor 2003*

Proçesi i stabilizim – asociimit (pSA) është korniza politike e BE-së për vende e Ballkanit Perëndimor: Shqipëria, Bosnja Hercegovina, ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Mali i Zi dhe Serbia përfshi Kosovën (sipas Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së). Kroacia, e cila ka nisur negociatat e anëtarësimit në tetor të vitit 2005 mbetet pjesë e proçesit. pSA do të jetë politika e Bashkimit Evropian për Ballkanin Perëndimor deri në anëtarësimin e tij në BE. Ai është një element kyç politik dhe strategjik në angazhimin afatgjatë të BE-së, i lidhur specifikisht me anëtarësimet e reja në BE dhe i përshtatur me nivelin e zhvillimit të secilit shtet në rajon, duke i lejuar ata të ecin me hapin e tyre dhe njëkohësisht duke nxitur fuqimisht bashkëpunimin rajonal. Ky është një partneritet progresiv, në të cilin BE, nëpërmjet Marrëveshjeve të Stabilizimit Asociimit, ofron një tërësi koncesionesh tregtare, ekonomike, ndihmë financiare dhe marrëdhënie kontraktuale.

Që kur Bashkimi Evropian (BE) i hyri rrugës së zgjerimit në vitin 2004, marrëdhëniet me rajonet fqinje kanë qenë prioriteti i tij kryesor në lidhje me marrëdhëniet me jashtë. Së bashku me Proçesin e Stabilizimit – Asociimit, Politika Evropiane e Fqinjësisë është përgjigjia e BE-së ndaj sfidave dhe mundësive të krijuara nga ndryshimi i kontekstit politik. Ndryshe nga Proçesi i Stabilizimit Asociimit, qëllimi përfundimtar i të cilit është përgatitja e vendeve të Ballkanit Perëndimor për anëtarësimin në BE, Politika Evropiane e Fqinjësisë është e shkëputur nga proçesi i zgjerimit. Kjo, megjithatë, nuk paragjykon për fqinjët evropianë, mënyrën se si mund të zhvillohen në të ardhmen marrëdhëniet me Bashkimin Evropian, në përputhje me dispozitat e Traktatit. Përmes Politikës Evropiane për Fqinjët, Bashkimi Evropian u ofron fqinjëve të tij në lindje

dhe jug një marrëdhënie të privilegjuar, të ngritur në angazhimin e dyanshëm për respektim të vlerave të përbashkëta dhe shmangien e krijimit të linjave të reja ndarëse. Mbi bazën e këtyre vlerave të përbashkëta, rajonet fqinjë ftohen për t'u angazhuar përtej bashkëpunimeve ekzistuese dhe të thellojnë lidhjet ekonomike, politike, kulturore dhe të sigurisë për të forcuar stabilitetin, sigurinë dhe mirëqenien për të gjithë palët. Dimensioni i bashkëpunimit ndërkombëtar në Programin “Youth in Action” kontribuon në arritjen e objektivave të Politikës Evropiane për Fqinjët për sa i përket “shkëmbimeve mes njerëzve”. Programi mbështet projektet që nxisin lëvizjen, shkëmbimin, dialogun dhe bashkëpunimin mes të rinjve, punonjësve rinorë dhe organizatave të ndryshme në të gjithë Evropën dhe përtej

saj. Programi inkurajon të rinjtë që të kenë një kuptueshmëri më të madhe mbi ndryshueshmërinë e kulturave në Evropë dhe vlerat e saj themelore. Ai kontribuon, gjithashtu, në forcimin e shoqërisë civile në të gjitha vendet pjesëmarrëse përmes bashkëpunimit rinor, promovimit dhe njohjes së vlerave të edukimit joformal dhe krijimit të mundësisë për të rinjtë dhe organizatat rinore, që të pajisen me aftësitë dhe kompetencat e duhura që do t'i hapnin rrugën përfshirjes së tyre në shoqëri në pozicionin e lojtarëve aktivë.

## Procesi i Stabilizim Asociimit

### Vendet e përfshira:

Shqipëria, Bosnja Hercegovina, Kroacia, Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Mali i Zi dhe Serbia përfshi Kosovën sipas rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së.

### Qëllimi përfundimtar:

Përgatitja për anëtarësimin në BE

### Akti i themelimit:

Këshilli i Evropës në Feira, qershor 2000, konfirmuar nga Këshilli i Evropës në Selanik në qershor 2003

## Politika Evropiane për Fqinjët

Vendet e përfshira: Algjeria, Armenia, Azerbajxhani, Bjellorusia, Egjipti, Gjeorgjia, Izraeli, Jordania, Libani, Libia, Moldavia, Maroku, Autoriteti Palestinez, Siria, Tunizia dhe Ukraina.

**Qëllimi përfundimtar:** Vendosija e një marrëdhënieje të privilegjuar mes BE-së dhe vendeve të përfshira, arritja e një angazhimi dypalësh vlerash të përbashkëta.

**Akti i themelimit:** Komunikata e Komisionit për një Evropë më të zgjeruar në mars të vitit 2003, e pasuar nga një Dokument Strategjik më i përparuar në lidhje me Politikën Evropiane të Fqinjësisë, publikuar në maj të vitit 2004.

*“Edhe pse Rusia është gjithashtu një fqinj i BE-së marrëdhëniet me Rusinë janë zhvilluar nëpërmjet një Parteriteti Strategjik që mbulon katër “sektorë të përbashkët”.*

## Politika Evropiane për Fqinjët

“Parimi bazë i Politikës Evropiane të Fqinjësisë është shumë i thjeshtë – ne duam që të zgjerojmë dhe shtrijmë prosperitetin, stabilitetin dhe sigurinë tashmë të arritur nga anëtarët e BE-së, edhe tek fqinjët tanë... Ne ndajmë interesa praktikë, ideale dhe aspirata të njëjta, ne përballemi me të njëjtat sfida, të tilla si ato të sigurisë, mjedisit, punësimit dhe migrimit. Ne duam një marrëdhënie që reflekton më së miri gjithë sa më sipër”

*Benita Ferrero-Waldner, Komisionere Evropiane për Marrëdhëniet me Jashtë dhe Politikën Evropiane me Fqinjët.*



# Një vështrim i shpejtë në lidhje me “Youth in Action” (“Rinia në Veprim”)

**Kohëzgjatja:** 2007-2013

**Buxheti:** 885 milionë Euro

**Grupmosha e synuar:** 15-28 vjeç  
(në disa raste 13-30), punonjësit rinorë dhe organizatorët

**Shtrirja gjeografike:**

- - Vendet e Programit: 27 vendet anëtare të BE-së, Islanda, Litejnshtejni, Norvegjia dhe Turqia

- - Vendet Partnere:

**Evropa Lindore dhe Kaukazi:**

Armenia, Azerbajxhani, Bjellorusia, Gjeorgjia, Moldavia, Federata Ruse dhe Ukraina.

**Vendet Partnere të Mesdheut:**

Algjeria, Egjipti, Izraeli, Jordania, Libani, Maroku, Autoriteti Palestinez i Bregut Perëndimor dhe Rripit të Gazës, Siria, Tunizia.

**Evropa Juglindore:**

Shqipëria, Bosnja Hercegovina, Kroacia, Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Mali i Zi, Serbia.

**Vende të tjera partnere në botë,** të cilat kanë nënshkruar marrëveshje me Bashkimin Evropian në fushën e rinisë.

## 5 Objektivat:

- - promovimi i qytetarisë aktive tek të rinjtë
- - nxitja e solidaritetit dhe tolerancës
- - edukimi i një mirëkuptimi dypalësh
- - rritja e cilësisë së sistemeve mbështetës për aktivitetet rinore dhe organizatat rinore
- - inkurajimi i bashkëpunimit evropian në fushën rinore

## 5 Aksionet / veprimet:

**Aksioni 1.** – Rinia për Evropën

(mbështetja e shkëmbimeve rinore, iniciativave rinore dhe projekteve rinore demokratike)

**Aksioni 2** – Shërbimi Vullnetar Evropian

(inkurajimi i aktiviteteve vullnetare jashtë shtetit, në dobi të komunitetit lokal)

**Aksioni 3** – Rinia në Botë

(shkëmbimet, trainimet, krijimi i rrjeteve dhe bashkëpunimi me vendet fqinjë dhe vende të tjera partnere në botë)

**Aksioni 4** – Sistemet Mbështetëse Rinore

(promovimi dhe zhvillimi i shkëmbimeve, trajnimeve, rrjeteve dhe skemave të informacionit)

**Aksioni 5** – Bashkëpunimi Evropian në fushën rinore

(mbështetja e politikës rinore të bashkëpunimit në nivel evropian)



## Mundësitë për bashkëpunim me Vendet Partnere të BE-së

Aksioni 3 fokusohet në bashkëpunimin me Vendet Partnere, një shprehje kjo që identifikon të gjitha vendet të cilat mund të përfshihen në Programin Youth in Action, por që nuk përcaktohen si Vendet e Programit. Aksioni 3.1 është për bashkëpunim me Vendet Partnere që konsiderohen vendet fqinjë. Kjo përfshin vendet në rajonet fqinjë të BE-së (Evropën Juglindore, Evropën Lindore dhe Kaukazin dhe vendet Euro-Med)

Aksioni 3.2 hap mundësi për bashkëpunim me vende të tjera të botës. Aksioni 3 mbështet shkëmbimet, trajnimet dhe ngritjen e rrjeteve në fushën rinore. Ndërkohë që fokusohet në promovimin e bashkëpunimit mes vendeve të BE-së, projekti ofron mundësi bashkëpunimi mes rajoneve të ndryshme fqinjë.

## Mundësitë për organizatorët e projekteve nga Evropa Juglindore për të dërguar aplikime në Komisionin

Mundësia për organizatat nga Vendet Partnere të Evropës Juglindore për të aplikuar për grante pranë Komisionit Evropian vazhdon edhe në Programin "Youth in Action". Një organizatë dërgon aplikimin në emër të të gjithë partnerëve të përfshirë në projekt, kështu partnerët nga Vendet e Evropës Lindore kanë mundësinë e ndërmarrjes, koordinimit dhe menaxhimit të projekteve evropiane. Për të gjitha projektet e përzgjedhura në nivel evropian, ka tre afate aplikimi në vit:

Projektet që fillojnë ndërmjet	Afati i aplikimit
1 Gusht dhe 13 Dhjetor	1 Shkurt
1 Dhjetor dhe 30 Prill	1 Qershor
1 Mars dhe 31 Korrik	1 Shtator

Për projektet e përzgjedhura në nivel kombëtar ka pesë afate aplikimi në vit:

Projektet që fillojnë ndërmjet	Afati i aplikimit
1 Maj dhe 30 Shtator	1 Shkurt
1 Korrik dhe 30 Nëntor	1 Prill
1 Shtator dhe 31 Janar	1 Qershor
1 Dhjetor dhe 30 Prill	1 Shtator
1 Shkurt dhe 31 Korrik	1 Nëntor

Organizatat nga Vendet Partnere mund të jenë partnere në projektet e dërguara në të 5 afatet, megjithatë ato nuk mund të dërgojnë vetë aplikime pranë Agjencive Kombëtare.

### Shërbimi Vullnetar Evropian (EVS)

EVS është i hapur si për të rinjtë nga Vendet Partnere ashtu dhe nga Vendet e Programit. Aktivitetet EVS mbulojnë një periudhë 2 deri në 12 mujore. Të gjitha organizatat nga Vendet e Programit dhe nga Evropa Juglindore, që duan të marrin pjesë në EVS, duhet të jenë të akredituara përpara dorëzimit të aplikimeve.

### Njohja e kompetencave kryesore

Për të promovuar më mirë njohjen dhe vlefshmërinë e kompetencave kyçe të përvetësuara gjatë pjesëmarrjes në projektet e realizuara brenda Programit, "Youth in Action" prezanton një instrument të ri, të quajtur "Youthpass". Pjesëmarrësit në Programin "Youth in Action" kanë të drejtë të pajisen me Youthpass si një njohje për përvojën e të mësuarit joformal që kanë marrë nga pjesëmarrja në projektin Youth in Action. Youthpass krijohet dhe jepet nga promovuesit e projektit. Më shumë informacion mund të gjeni në: <http://www.youthpass.eu/>



## Shkëmbimet rinore

**Shkëmbimet rinore ofrojnë mundësitë unike për t'u fokusuar në tema të ndryshme ndërsa krijohet një atmosferë mirëkuptimi dhe respekti ndërmjet kulturave të ndryshme.**

Projektet e shkëmbimeve rinore bëjnë bashkë grupe të rinjsh nga dy ose më shumë vende, duke u dhënë mundësinë të rinjve të vizitojnë njëri-tjetrin dhe të bashkëpunojnë në fushat me interes të përbashkët. Përfshirja e të rinjve me më pak mundësi inkurajohet si një prioritet i rëndësishëm



### **Kush përfshihet?**

Një projekt mund të zgjasë nga 6 deri në 21 ditë dhe mund të përfshijë nga 16 deri në 60 pjesëmarrës. Si rregull i përgjithshëm, të gjithë të rinjtë nga 13 deri në 25 vjeç, banorë në një prej vendeve pjesëmarrëse mund të marrin pjesë, pavarësisht shkollimit apo përvojave të mëparshme. Në disa raste parashikohen përjashtime si në rastin e përfshirjes së të rinjve nga moshat 26 deri në 30 vjeç.

i Programit Youth in Action. Projektet mund të bazohen në një tërësi temash të ndryshme. Ato duhet të reflektojnë interesat e të rinjve të përfshirë dhe të jenë në një linjë me tematikën e përgjithshme të Programit Youth in Action (YiA). Të gjitha projektet duhet të ofrojnë mundësi edukimit joformal për të rinjtë e synuar dhe të përfshirë në programin e përditshëm. Të gjithë elementët e projektit duhet t'i përshtaten temës së përgjithshme dhe projektet duhet të kenë një ndikim afatgjatë, jo vetëm tek të rinjtë pjesëmarrës, por edhe tek komunitetet pritëse dhe dërguese.

### **Një grup partner mund të jetë një organizatë jofitimprurëse, një organizëm rajonal apo lokal ose një grup jo formal rinor.**

Udhëheqësit e grupeve marrin përgjegjësinë për përgatitjen dhe zbatimin e projekteve. Megjithatë, është shumë e rëndësishme që vetë të rinjtë të përfshihen në të gjitha etapat e projektit që nga planifikimi, realizimi dhe faza përfundimtare. Në secilin prej grupeve duhet të ketë një numër të balancuar të rinjsh. Numri i anëtarëve të Vendeve të Programit dhe Vendeve Partnere duhet të jetë gjithashtu i balancuar. Çdo shkëmbim duhet të përfshijë të paktën një vend anëtar

### **Temat:**

Shoqëria, mirëkuptimi kulturor, pranueshmëria e grupeve të pakicave, dialogu ndërkulturor dhe ndërftetar, zgjidhja e konflikteve dhe rindërtimi pas konflikteve, trashëgimia, mbrojtja e mjedisit etj...

të Bashkimit Evropian, por ai mund të organizohet në secilin nga shtetet e vendeve pjesëmarrëse, përveç Vendeve Partnere të Mesdheut.

### **Një dimension ndërkulturor dhe mundësi shumë të mëdha**

Projektet e shkëmbimeve rinore janë mënyra shumë të mira për të zhvilluar punën rinore në komunitetet lokale. Ato rrisin përmasat ndërkulturore dhe sigurojnë mundësi të shkëlqyera për të rinjtë. Shkëmbimet mund të jenë veçanërisht motivuese sidomos për të rinjtë që për arsye nga më të ndryshmet ndihen të përjashtuar nga shoqëria. Takimi mes të rinjve nga vende të ndryshme zgjeron horizontin e të rinjve dhe u jep shtysë që t'i shohin gjërat nga një tjetër perspektivë. Ka shumë shembuj projektesh të suksesshëm që kanë pasur një ndikim shumë të madh në zhvillimin personal të pjesëmarrësve të rinj. Një i ri, veçanërisht ai që vjen nga një jetë e vështirë, mund të rizbulojë një qëllim në jetë, mund të gjejë rrugë të reja të pjesëmarrjes në shoqëri.



## Shembuj të Shkëmbimeve Rinore

Një shkëmbim rinor bëri bashkë 60 persona të shurdhër dhe me vështirësi në të dëgjuar nga Bosnja Hercegovina, Italia, Kroacia, Portugalia, Serbia, Mali i Zi dhe Sllovenia për dhjetë ditë. Aktiviteti u organizua në Kotorr, një qytet historik bregdetar në Mal të Zi. Qëllimi kryesor i shkëmbimit ishte përgatitja për një performacë teatrore. "Ishte e mrekullueshme të shihje se sa shumë u lidhëm me njëri-tjetrin gjatë atyre ditëve. Ishim persona të ndryshëm, shumë të ndryshëm dhe brenda një kohe të shkurtër u bëmë aq të afërt me njëri tjetrin, si të kishim vite që ishim njohur. Që andej bëmë plane për takime të ardhshme... Ne ikëm me një përvojë shumë pozitive, mendime pozitive por mbi të gjitha, kaluam një javë të mrekullueshme dhe bëmë diçka të mirë, diçka që do ta mbajmë mend për një kohë të gjatë" (një pjesëmarrës nga Sllovenia).

Një organizatë gjeorgjiane dhe një grup britanik i dhanë jetë një projekti shkëmbimi rinor të quajtur: "Evropa takon tokën e Medeas" – një shkëmbim rinor që kundërshtonte ksenofobinë dhe stereotipet si dhe promovonte mirëkuptimin ndërkulturor. Në këtë projekt u përfshinë 6 grupe të rinjsh nga Ukraina, Gjeorgjia, Rusia, Britania e Madhe, Estonia dhe Gjermania. Secili grup ishte i përbërë nga 4 pjesëmarrës dhe një udhëheqës grupi. Bazuar në legjendën e Medeas nga mitologjia greke, pjesëmarrësit diskutuan origjinën dhe pasojat e ksenofobisë dhe stereotipeve ndaj vendeve të huaja. Në të ashtuquajturën "Zbulim Kulturor" të organizuar nga më të rinjtë, ata duhet t'u tregonin pjesëmarrësve zakonet e kombeve të tyre, traditat dhe aspektet kulturore për të tërhequr vëmendjen ndaj vlerave të përbashkëta dhe mirëkuptimit të dallimeve kulturore. "Një nga elementët kryesorë të shkëmbimit ishte vetëorganizimi i pjesëmarrësve. Kjo gjë kontribuoi në rritjen e përgjegjësisë së pjesëmarrësve, rritjen e aftësive për t'i zgjidhur problemet në mënyrë të pavarur si dhe inkurajimin e tyre për të shprehur opinionet dhe për të respektuar e pranuar mendimet e të tjerëve. Në këtë mënyrë u mbështet zhvillimi personal i të rinjve, u promovua toleranca dhe u pakësuan paragjykimet." (një pjesëmarrës nga Gjeorgjia).

Një punonjës rinor nga veriperëndimi i Gjermanisë organizoi një shkëmbim rinor për 16 të rinj nga vende të ndryshme të Mesdheut me titullin: "Takim me historinë për të kuptuar të tashmen dhe për të përmirësuar të ardhmen". Qëllimi kryesor ishte bërja bashkë e të rinjve që vinin jo vetëm nga vende të ndryshme, por edhe nga tre grupime të ndryshme fetare, islami, judaizmi dhe krishtërimi. Pjesëmarrësit nga Egjipti, Izraeli, Palestina dhe Spanja kaluan dy javë së bashku duke diskutuar për racizmin, ksenofobinë dhe mësimin ndërkulturor si dhe mësuam si të përmirësonin respektin reciprok përmes ligjërimeve ndërkulturore. Përpjekjet e tyre u nderuan me çmimin "Euromed Youth" në Kajro.

"Për mua ky takim më ndryshoi mendimin që kisha për palestinezët" (një vajzë izraelite në prani të Lordit të Hammit gjatë takimit në qytetin me të njëjtin emër).



"Për herë të parë në jetën time kam shpresë se paqja është ende e mundur" (një palestinez në vlerësimin përfundimtar të projektit).



## Shërbimi Vullnetar Evropian (EVS - SHVE)

### Zbulimi i kulturave të reja dhe pajisja me aftësi të reja

Projektet EVS u japin të rinjve shansin për të jetuar dhe punuar si vullnetarë në vende të tjera për një periudhë deri në 12 muaj. Aktivitetet e vullnetarizmit janë në përfitim të komuniteteve lokale, por ato kanë edhe qëllime edukimi për vetë vullnetarët.

**Vullnetarët punojnë shpesh me grupe njerëzish si: fëmijët, adoleshentët, personat me aftësi të kufizuara, imigrantët, pleqtë, të pastrehët dhe grupe pakicash të tjera. Projektet gjithashtu mund të jenë kulturore ose të lidhura me mjedisin.**

#### **Kush mund të marrë pjesë?**

EVS është i hapur ndaj të gjithë të rinjve me moshë nga 18 deri në 30 vjeç nga Vendet e Programit ose Vendet Partnere, pavarësisht shkollimit apo përvojave të mëparshme. Në disa raste mund të ketë përjashtime për persona të moshave 16-17 vjeçare, të cilët mund të pranohen gjithashtu. Pjesëmarrja për vullnetarët është falas, gjatë projektit ata kanë të siguruar qëndrimin, ushqimim, siguracionin si dhe marrin një sasi të hollash gjatë kohës së projektit. Përfshirja e të rinjve me mundësi të kufizuara inkurajohet si një nga prioritetet e Programin Youth in Action.

#### **Një përvojë personale shumë e pasur**


Një i ri mund të ketë shumë përfitime nga një shërbim vullnetar në një vend tjetër. Duke jetuar dhe punuar në mjedise të ndryshme, vullnetarët zbulojnë shumë gjëra për veten ndërkohë që mësojnë të përshtaten me një kulturë tjetër dhe të përfitojnë aftësi të reja. Projektet e vullnetarëve janë të rëndësishme për komunitetet lokale. Vullnetarët nuk duhet të zëvendësojnë stafin që paguhet, por kontributi i tyre duhet të jetë në përfitim të organizatës dhe komunitetit vendas. Një vullnetar nga një vend tjetër sjell në projekt një dimension të ri kulturor, që mund të çojë në zhvillime të reja në komunitetin përkatës.

#### **Çdo projekt EVS mund të përfshijë nga 1 deri në 100 vullnetarë.**

Aktivitetet individuale EVS përfshijnë një vullnetar, një organizatë dërguese dhe një organizatë pritëse, ndërsa aktivitetet në grup mund të përfshijnë deri në 100 vullnetarë; disa organizata

mund të organizohen në nivel lokal, rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar. Një nga organizatat e përfshira koordinon projektin dhe dërgon aplikimin në emër të të gjithë partnerëve. Aplikimet mund të drejtohen në Agjencitë Kombëtare të Vendeve të Programit ose te Agjencia Ekzekutive e Edukimit, Audiovizuale dhe Kulturore. Projektet EVS duhet të përfshijnë të paktën një shtet nga vendet anëtare të BE-së dhe numri i vullnetarëve dhe organizatave partnere nga Vendet Partnere Fqinje nuk mund ta kalojë numrin e vullnetarëve dhe organizatave partnere nga Vendet e Programit.

Një bazë të dhënash me të gjitha organizatat e akredituara dërguese dhe pritëse gjendet on-line dhe u ofron vullnetarëve potencialë ide në lidhje me EVS. Organizatat pritëse kontaktohen me ndihmën e organizatave dërguese. Organizatat më pas mund të merren me të gjitha anët teknike dhe procedurat për vullnetarët.



## Shembuj të projekteve EVS

Një grua e re nga Franca shkoi vullnetare në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Ajo punoi në një projekt që ndihmonte refugjatët në rajonin e Prespës, në jugperëndim të Maqedonisë. 52 familje refugjatësh jetonin në një hostel të vjetër buzë liqenit të Prespës. Ata janë maqedonas etnikë nga Shqipëria të cilët erdhën aty në fillim të viteve 1990 për shkak të problemeve ekonomike. Pjesa më e madhe e tyre kishin mbi 10 vjet që ishin vendosur në Prespë por kushtet e jetesës ishin akoma shumë të vështira dhe nuk ishin përmirësuar gjate qëndrimit të tyre aty. Edhe pse më në fund, në vitin 2004 morën nënshkrimin e Maqedonase, ata nuk kishin mjetet e duhura për të nisur një jetë të re si qytetarë maqedonas.

Vullnetarja punoi me një grup vullnetarësh vendas dhe ndërkombëtarë për të rritur ndërgjegjësimin në Shkup dhe Maqedoni në lidhje me kushtet e vështira të jetës së banorëve të këtij komuniteti. Vullnetarët punuan me autoritetet vendore të Shkupit dhe Resenit si dhe me sektorin e biznesit në Maqedoni për t' u siguruar refugjatëve veshmbathje, ushqim dhe sende të tjera të nevojës së përditshme. Gjithashtu ata kaluan kohë edhe me fëmijët dhe të rriturit e komunitetit. Vullnetarja e konsideroi kontaktin personal me refugjatët si pjesën më të rëndësishme të projektit.

“Përveçse u siguronim veshmbathje, ne kishim rastin të zhvillonim biseda të gjata me disa nga personat që jetonin aty dhe t' u bënim pyetje në lidhje me prejardhjen, gjendjen e tyre në Maqedoni si dhe ndjenjat e shpresat për të ardhmen. Kjo pjesë e projektit është pa dyshim ndër më interesante, duke qenë se të jep mundësi direkte për të kuptuar situatën dhe për të vendosur lidhje me njerëzit. Ishte sigurisht një moment i rëndësishëm, pasi siç më tha dikush, për ta ishte diçka shumë e rrallë që dikush të vinte e të interesohet për gjendjen e tre e mbi të gjitha të dëgjonte historitë e tyre, pasi ata kanë vërtetë shumë shumë për të rrëfyer”.

Një i ri me aftësi të kufizuara nga një minoritet Armen shkoi në Vilnius të Lituanisë për të punuar me jetimët. Detyra e tij ishte të punonte me grupe fëmijësh të moshës 9-15 vjeç në një jetimore në Vilnius. Vullnetari ishte përgjegjës për organizimin e kohës së lirë të fëmijëve, të ndihmonte në përgatitjen dhe organizimin e projekteve edukative dhe zbatimës të jetimores, shoqërimin e tyre në udhëtime të ndryshme dhe të merrte pjesë së bashku me jetimët në aktivitetet e organizuara në nivel bashkie dhe kombëtar. Përmes komunikimit të vazhdueshëm me fëmijët lituanëzë dhe stafin e jetimores, vullnetari njohu kulturën e atij vendi dhe zbuloi se si shihej kultura e vendit të tij nga të tjerët. Vullnetari mori mësim gjuhe dhe kishte një mentor me të cilin pati lidhje shumë të mira. Ky i fundit e mbështeti me materiale praktike dhe i dha një ndihmesë të madhe për t' u integruar në komunitet.

“Çdo person i përfshirë në EVS ka mundësinë që të bëhet më i fortë në nivelin personal dhe të ketë shumë më tepër besim tek vetvetja. Si vullnetar mëson se është shumë e rëndësishme të ndërmarrësh iniciativë personale, të kuptosh vlerat e solidaritetit, vullnetarizmit dhe respektit për dallimet ndërkulturore dhe të kontribuosh në mënyrë aktive me dijen dhe aftësinë tënde për të bërë ndryshime në nivel lokal, kombëtar ose ndërkombëtar”

Një portugez 25 vjeçar shkoi vullnetar në Jordani për projektin e tij EVS “Ndiqni gratë”. Projekti ishte pjesë e një lëvizjeje e krijuar për të ndërgjegjësuar opinionin në lidhje me situatën e grave dhe fëmijëve në Lindjen e Mesme si dhe dhënia e mbështetjes për këtë kategori të popullsisë. Një nga arsyet që e tërhoqën vullnetarin drejt këtij projekti ishte mundësia për të mësuar më shumë në lidhje me gjendjen në Lindjen e Mesme dhe njëherazi për të luajtur një rol në një projekt ambicioz paqeje. “Ndiqni gratë” ishte një mënyrë e re eksperimentimi kulturor, fetar dhe social. “Përfshirja ime ishte “e thellë” dhe unë e përjetova gjithë përvojën në këtë projekt në mënyrë intensive. Ndihem i privilegjuar që pata mundësinë e përfshirjes në një projekt të tillë nga fillimi deri në fund”.



## Trajnimi dhe aktivitetet e rrjetit

*Zhvillimi i një bashkëpunimi të ardhshëm mes organizatave partnere  
Bashkëpunimi dhe partneriteti, mënyrat e trajnimit dhe shkëmbimet e përvojave të mira janë  
temat kyçe të zhvillimit të organizatave rinore, shoqërisë civile dhe të gjithë faktorëve që  
përfshihen në punën me rininë.*

Programi "Youth in Action" ofron mundësi të ndryshme për projektet që promovojnë shkëmbimin e përvojave, bashkëpunimin dhe trajnimet në punën rinore evropiane. Këto projekte kanë vlerë edhe për përparimin dhe zhvillimin e bashkëpunimit të organizatave pjesëmarrëse dhe rritjen e cilësisë së aktiviteteve të mbështetura nga Programi.

**Temat prioritare** përfshijnë forcimin e shoqërisë civile, qytetarinë dhe demokracinë, luftën kundër racizmit dhe ksenofobisë, dialogun ndëretnik dhe ndërfetar, zgjidhjen e konflikteve, rindërtimin pas konflikteve, rolin aktiv të grave në shoqëri, të drejtat e pakicave dhe mbrojtjen e trashëgimisë dhe mjedisit.

**Projekti mund të përfshijë aktivitete të tilla si job shadowing (punë praktike), vizitat e fizibilitetit, vizitat studimore, aktivitetet për krijimin e partneriteteve, takimet vlerësuese, seminare, kurse trajnimi dhe projekte në rrjet.**



Këto aktivitete janë për të rinjtë, por edhe për ata që punojnë me të rinjtë. Pra nuk ka një kufizim në moshë për pjesëmarrësit, madje mund të marrin pjesë edhe persona mbi 50 vjeç, në varësi të natyrës së projektit. Një projekt i mirëkonceptuar, që reflekton temat kryesore të projektit, duhet të dorëzohet së bashku me aplikimin.

**Trainimi dhe projektet e rrjetit janë shumë të rëndësishëm për zhvillimin e një bashkëpunimi të mëtejshëm. Ato u japin mundësi organizatave partnere që të mësojnë më shumë nga puna e njëra tjetrës dhe të eksplorojnë mundësitë për zhvillimin projekteve të reja.**



Kritere të ndryshme aplikohen për projekte të ndryshme, por secili projekt duhet të ketë të përfshirë të paktën një shtet të Bashkimit Evropian. Numri i Vendeve të Programit dhe i Vendeve Partnere të përfshira në projekt duhet të jetë i balancuar dhe për shumicën e projekteve duhet të përfshihen të paktën dy Vende të Programit dhe dy Vende Partnere Fqinje. Projektet e job shadowing (punës praktike) dhe vizitat e fizibilitetit mund të përfshijnë vetëm një Vend të Programit dhe një Vend Partner Fqinj.



## Shembuj të Trajnimeve dhe Projekteve të Rrjetit

Një organizatë shqiptare organizoi në Tiranë, Shqipëri një vizitë studimore në lidhje me përfshirjen sociale të pakicave në shoqëri për 14 të rinj nga vende të ndryshme. Organizatat partnere punonin me grupet e pakicave në Belgjikë, Poloni, Bosnje Hercegovinë dhe Shqipëri. Ata vizituan shumë organizata rinore shqiptare, morën pjesë në diskutime dhe ushtrime dhe hodhën ide për projekte të tjera në të ardhmen.

"Ne e dinim se ekzistonin shumë paragjykitime për vendin tonë dhe kjo na bëri që të ndiheshim më të përgjegjshëm. Çuditërisht, nisëm ta shohim qytetin tonë me një sy tjetër... Nuk e dinim nëse disa punime ndërtimi do të përfundonin në kohën e duhur. Ishte me të vërtetë një përvojë shumë interesante të merrje pjesë në një vizitë studimore dhe shpresoj se do të ketë të tjera në të ardhmen" (pjesëmarrës shqiptar)

"Tirana në vetvete është një qytet interesant me një personalitet krejtësisht të vetin. Unë nuk do ta harroj kurrë mikpritjen dhe zemrën e mirë të njerëzve që takuam dhe mënyrën e tyre të qetë e të ngrohtë të të komunikuarit. Shpresoj shumë, që të kthehem sërisht në Tiranë dhe jam i sigurt që do t'i takoj sërisht personat me të cilët u prezantova, këtë herë jo më si pjesëmarrës, por si miq". (pjesëmarrës belg)


Disa organizata joqeveritare nga tre vende të BE-së (Franca, Gjermania dhe Spanja) dhe tre vende të EECA (Bjellorusia, Ukraina dhe Armenia) organizuan një vizitë fizibiliteti në Marsejë të Francës. Vizita synonte të vendoste kontakte mes 11 udhëheqësve dhe drejtuesve të projekteve nga organizata të ndryshme për të diskutuar dhe përgatitur një seminar si dhe projekte të tjera në kuadrin e Programit YIA. Gjatë vizitës u diskutuan dhe u zhvilluan projekte rinore, që do të praktikojnë mjetet edukative dhe metodat që promovojnë të mësuarit ndërkulturor dhe edukimin civil. Pjesëmarrësit patën mundësinë që të takoheshin me shefin e Agjencisë Kombëtare Franceze dhe t'i bënin pyetje në lidhje me Programin. Menjëherë pas vizitës, pjesëmarrësit hartuan dhe aplikuan për disa projekte të përbashkëta.

"Kur thua Evropë, mendon për një tërësi vendesh, kombesh dhe kulturash. Kontinenti është një "enë" unike dhe një pikëkalimi për shumë njerëz. Duhet të mbajmë mend se ka shumë vende mahnitëse dhe njerëz të tillë që jetojnë prej kohësh në Evropë, por jo në Bashkimin Evropian. Diversitetin kulturor evropian mund ta ndjesh veçanërisht kur shkon përtej kufijve të BE-së (punonjërs rinor rus).

Në një botë ku ndërveprimi njerëzor po rritet gjithnjë e më shumë, menaxhimi paqësor dhe demokratik i konflikteve është shumë i rëndësishëm. Një seminar i titulluar "Menaxhimi i konflikteve dhe Paqja" u organizua në Ankara të Turqisë dhe përfshiu 35 të rinj e punonjës rinorë nga 11 vende të ndryshme të Evropës dhe pellgut të Mesdheut. Seminari synonte përmirësimin e njohurive të pjesëmarrësve në lidhje me zgjidhjen e konflikteve dhe u mësoi atyre mënyrat e komunikimit dhe negociimit me të tjerët. Drejtuesit e seminarit u kërkuan pjesëmarrësve t'i jepnin zgjidhje një problemi real në të cilin duhet të përfshiheshin negociatat dhe komunikimi efektiv. U organizua gjithashtu edhe një "lojë", qëllimi i së cilës ishte ngjallja e ndjenjës së simpatisë për njëri-tjetrin. Vlerësimi i projektit ishte pjesë integrale e seminarit dhe u zhvillua në faza të ndryshme.



"Ne ishim si pemët, kishim rrënjë solide në civilizimin tonë, kulturën dhe prejardhjen me një aftësi të madhe për t'iu hapur të tjerëve, për të ndarë, për t'u mbledhur, për të mësuar dhe për të pranuar" (një pjesëmarrës).





# Qendrat burimore të Saltos

## 8 qendrat burimore të SALTO-s të ngritura në qytete evropiane:

- Mbështesin organizuesit e projektit dhe Agjencitë Kombëtare
- Promovojnë bashkëpunimin
- Përmirësojnë cilësinë e projekteve
- Sigurojnë burime për punë rinore dhe trajnime
- Organizojnë trajnime dhe aktivitete për ngritjen e partneriteteve.

## Secili ka zonën e prioritetit në të cilën punon:

Diversiteti kulturor

Përfshirja

Informacioni

Pjesëmarrja

Trajnimi dhe bashkëpunimi

## Tre SALTOT rajonale

Evropa Lindore dhe Kaukazi

EuroMed

Evropa Juglindore

Të tre qendrat rajonale të SALTO-s promovojnë bashkëpunimin mes Vendeve të Programit dhe Vendeve Partnere Fqinje të BE-së

## Qëllimet kryesore janë:

- Të kontribuojnë për paqen dhe stabilitetin në kufijtë e BE-së së zgjeruar dhe përtej, duke zhvilluar dialogun ndërkulturor, mirëkuptimin reciprok dhe tolerancën ndërmjet të rinjve:
- Të kontribuojnë për forcimin e demokracisë dhe shoqërisë civile në rajone, përmes lehtësimit dhe integritit si dhe pjesëmarrjes aktive të të rinjve dhe inkurajimit e zhvillimit të strukturave rinore.

Për më tepër informacion vizitoni: [www.salto-youth.net](http://www.salto-youth.net)

**S**upport  
**A**dvanced  
**L**earning  
**& T**raining  
**O**pportunities  
 (Mbështet  
 Mundësitë e  
 Mëtejshme për  
 Edukim dhe  
 Trajnim)



# Evropa Juglindore

"Ne e dinim që ka shumë paragjyime për vendin tonë dhe kjo na bëri që të ndiheshim më të përgjegjshëm. Çuditërisht nisëm ta shohim qytetin tonë me një sy tjetër. Ishte një eksperiencë e mrekullueshme dhe shpresoj se do të pasohet nga të tjerë në të ardhmen".

Qendra Burimore e Saltos për Evropën Juglindore (SALTO SEE) promovon bashkëpunim mes Vendeve të Programit YIA dhe Vendeve Partnere në Ballkanin Perëndimor

- Jep informacion në lidhje me mundësitë për bashkëpunim mes Vendeve të Programit dhe Vendeve Partnere në Evropën Juglindore;
- Ofron ndihmë në gjetjen e partnerëve për projektet e YIA që përfshijnë Vendet e Programit dhe Vendet Partnere në Evropën Juglindore;
- Koordinon dhe organizon aktivitetet edukative;
- Prodhon, mbledh dhe shpërndan informacion dhe materiale përkatëse për të bashkëpunuar në këtë fushë;
- Jep mbështetje dhe ekspertizë në të gjitha çështjet që kanë lidhje me përfshirjen dhe promovimin e bashkëpunimit të YIA me Evropën Juglindore.

## Një bashkëpunim i ngushtë me Agjencitë Kombëtare

Qendra e Saltos për Evropën Juglindore punon me Agjencitë Kombëtare për organizimin e **seminareve dhe aktiviteteve trajnuese**. Seminarët e organizuara nga Qendra bëjnë bashkë njerëz që punojnë në fushën rinore në Evropën Juglindore dhe vende të tjera të Evropës. Ato ndihmojnë në zhvillimin e partneriteteve për bashkëpunime të ardhshme, në veçanti në zhvillimin e projekteve të YIA të tillë si Shkëmbimet Rinore, EVS dhe projektet e Trajnimit dhe Rrjetit. Ato gjithashtu synojnë që t'u japin pjesëmarrësve informacionin dhe mjetet e duhura për realizimin e projekteve. Që nga viti 2006,

## Baza e të dhënave të organizatave partnere

Qendra ka një bazë të dhënash të organizatave partnere potenciale nga Evropa Juglindore dhe një forum partner-kërkues. Të dy janë të publikuar në faqen e internetit të Qendrës.

Qendra akrediton organizatat EVS në Evropën Juglindore dhe që nga viti 2007 e më tej ajo do të jetë përgjegjëse për koordinimin e trajnimeve EVS në Evropën Juglindore.

## Pikat e Kontaktit

Një nga mënyrat përmes të cilave SALTO përmbush objektivat e sipërpërmendura është bashkëpunimi me Pikat e Kontaktit, të cilat janë të vendosura në të gjitha vendet e Evropës Juglindore (të paktën në një organizatë për secilin vend). Qëllimi kryesor i Pikave të Kontaktit është të kontribuojnë në vizibilitetin dhe vlefshmërinë e Programit YIA në favor të organizatave të interesuara, institucioneve dhe grupeve rinore joformale në vendet përkatëse.

## Shembuj të punës së Pikave të Kontaktit janë:

- Promovimi i Programit "Youth in Action" dhe rritja e vizibilitetit të tij (në varësi të burimeve dhe kapaciteteve të tyre, kjo mund të bëhet nëpërmjet internetit, shpërndarjes së buletineve, publikimeve dhe materialeve të tjera promovionale, medias dhe aktiviteteve të tjera).
- Shpërndarja e informacionit dhe këshillimi në lidhje me zhvillimin dhe shkruarjen e

projekt propozimeve, gjetja e organizatave partnere dhe procedurat e aplikimit në rajonin ku janë përgjegjës Pikat e Kontaktit.

Pikat e Kontaktit nuk janë organizatat, ku ju duhet të dorëzoni projekt propozimet. Të jesh një Pikë Kontakti nuk do të thotë domosdoshmërisht të marrësh pjesë në ndonjë aktivitet brenda Programit YIA. Ashtu sikurse edhe organizatat e tjera nga vendet e Evropës Juglindore, Pikat e Kontaktit mund të dërgojnë projekt propozimet e tyre direkt në Komisionin Evropian duke ndjekur kriteret e përcaktuara për vendet partnere. Ato mund të marrin pjesë gjithashtu në projektet e organizatave të tjera si partnere. Disa nga gjërat që mund dhe duhet të bëjnë Pikat e Kontaktit janë: dhënia e informacionit, organizimi i ditëve të informacionit dhe i trajnimeve, mbështetja e interesit të shprehur nga organizatat e ndryshme në lidhje me Programin YIA si dhe mbështetja e organizatave për të gjetur partnerë dhe për të organizuar projekte ndërkombëtare brenda Programit. Informacionin në lidhje me Pikat e Kontaktit mund të gjeni në: <http://www.salto-youth.net/contactpoints>

"Cilido që merr pjesë në EVS ka mundësinë e forcimit në nivel personal dhe mundësinë e të qenurit një qenie me besim më të madh në vetvete dhe më e pavarur. Si vullnetar i EVS, mëson se është shumë e rëndësishme që në jetë të marrësh iniciativa personale, të kuptosh vlerat e solidaritetit, vullnetarizmit dhe respektit për ndryshimet kulturore dhe të kontribuosh në mënyrë aktive me gjithë njohuritë dhe aftësitë për të sjellë ndryshime në nivel lokal, kombëtar ose ndërkombëtar". (Një vullnetar slloven në Serbi)

## SALTO South-East Europe Resource Centre

**MOVIT NA MLADINA**  
Dunajska 22, SI-1000 Ljubljana, Slovenija  
Telefon: +386 1 430 47 47  
Fax: +386 1 430 47 49  
E-mail: [see@salto-youth.net](mailto:see@salto-youth.net)  
<http://www.salto-youth.net/see/>



## Botimet tona

Një gazetë elektronike e përmuajshme me informacion në lidhje me aktivitetet e Qendrës dhe zhvillimet e fundit

Një revistë në lidhje me punën rinore dhe në bashkëpunim me Evropën Juglindore – SEE YOUth! – me artikuj në lidhje me projekte të së shkuarës dhe aktuale, informacion shtesë dhe mendime.

Profillet e vendeve

Manuale dhe guida

Raporte të aktiviteteve të organizuara nga Qendra (Të gjitha publikimet mund t'i gjeni të pasqyruara edhe on-line në faqen tonë të internetit. Kopjet e printuara mund t'i kërkohen qendrës.)





## Evropa Lindore dhe Kaukazi

“Evropa Lindore dhe Kaukazi janë rajone jashtëzakonisht të rëndësishme, jo vetëm për shkak të numrit të madh të njerëzve që jetojnë në këto zona, por kryesisht për shkak të faktit se nuk ka Evropë pa pjesën lindore të kontinentit. Siç e themi dhe ne, Evropa ka një mushkëri të majtë dhe një të djathtë dhe ajo ka nevojë për të dyja, që të marrë frymë në mënyrë paqësore”.

Qendra e SALTO-s për Evropën Lindore dhe Kaukazin (SALTO EECA) mbështet bashkëpunimin për Programin YiA me Vendet Patnere Fqinje nga Evropa Lindore dhe Rajoni i Kaukazit në mënyrë që të:

- Rrisë e **vizibilitetin dhe ndërgjegjësimin** në lidhje me Programin YiA dhe mundësitë e tij për Evropën Lindore dhe Kaukazin;
- Promovojë **bashkëpunimin** me Vendet Partnere EECA përmes organizatave rinore në Vendet e Programit;
- Mbështesë Agjencive Kombëtare përmes zhvillimit të kontakteve, krijimit të **partneriteteve** dhe nxitjes së **ekspertizës** në bashkëpunim me rajonin EECA.

Jeni të mirëpritur të vizitoni faqen tonë të internetit: [www.salto-youth.net/EECA](http://www.salto-youth.net/EECA)

dhe [salto-youth.net/EECA](http://salto-youth.net/EECA) dhe të përdorni shërbimin tonë mbështetës [www.salto-eeca.eu](http://www.salto-eeca.eu) Për të ndërtuar një platformë sa më efiçente dhe bashkëpunuese me Vendet e Programit dhe Vendet Partnere Fqinje EECA dhe për të forcuar partneritetet ekzistuese, qendra ofron aktivitete, forma dhe mjete të ndryshme mbështetjeje.

### Keni nevojë për partnerë?

- Lista e kontaktit përmban adresat dhe fushat e interesit të OJF-ve nga BE dhe EECA. [www.salto-eeca.eu/contactlist](http://www.salto-eeca.eu/contactlist)
- Forumi i EECA është një hapësirë për projekt propozime, shkëmbim përvojash, raportesh dhe fotosh nga aktivitete të ndryshme: [www.salto-eeca.eu/forum\\_](http://www.salto-eeca.eu/forum_)

[eu/forum\\_](http://www.salto-eeca.eu/forum_)

- Aktivitetet për krijimin e partneriteteve organizohen në intervale të rregullta

### Çfarë duhet të dimë më tepër për EECA?

- -Manuali i EECA ka profilet e 7 vendeve: [www.salto-youth.net/Eecamanua](http://www.salto-youth.net/Eecamanua)
- Vizitat e Shkurta Studimore mund t'ju mësojnë gjërat bazë në lidhje me rajonin.

### Çfarë duhet të dimë për të organizuar një projekt të suksesshëm?

- Publikimet e EECA përfshijnë gazeta informuese, fletëpalosje, revista me ngjyra "Youth in 7" dhe mjete trajnimi: [www.salto-youth.net/eecapublications](http://www.salto-youth.net/eecapublications)
- Ekziston një rrjet zhvilluesish projektesh që përfshin punonjës rinorë nga vendet EECA të cilët promovojnë dhe mbështesin YiA: [www.salto-youth.net/eecamultipliers\\_](http://www.salto-youth.net/eecamultipliers_)
- Seminaret informuese dhe kurset e trajnimit japin gjithë informacionin e duhur për të organizuar dhe realizuar projektete

"Më pëlqeu shumë të jetoja atje. Fillimisht shkon me një ndjenjë që çdo gjë do të jetë krejtësisht e ndryshme nga ajo me të cilën je mësuar, por në fakt nuk ka ndryshime thelbësore, ndryshime të cilat nuk mund t'i përballosh dhe në fund të fundit, gjërat nuk janë edhe aq të ndryshme. Për aq kohë sa ndenja, kam takuar shumë njerëz të mirë, interesantë dhe kam parë e mësuar shumë mbi gjithçka. Nuk e prisja kështu". (vullnetare austriake në Ukrainë).

"Mendoj se projekti im ishte shumë i dobishëm. Përmes tij ata mësuuan anglisht dhe tani e kalojnë kohën duke luajtur lojra, duke vizatuar e kështu me radhë. Gjithmonë shprehin kënaqësinë e tyre dhe kjo më nxit që të punoj më shumë dhe t'i ndihmoj". (vullnetare finlandeze në Azerbajxhan).



# Euro-Med

Qendra Burimore e SALTO-s Euro-Med, mbështet bashkëpunimin mes vendeve Evropiane dhe mesdhetare në katër mënyra:

## 1. Mundësi trajnimi dhe eventimentesh



Qendra Burimore e SALTO-s Euro-Med punon me Agjencitë Kombëtare për të

propozuar kurse trajnimi novative dhe me tematikë të ndryshme në vendet Euro-Med me prioritet rininë. Ato përfshijnë luftën kundër racizmit, vendin që duhet të ketë gruaja në shoqëri dhe të drejtat e pakicave si dhe i japin mundësi pjesëmarrësve që t'i përfshijnë këto prioritet në projektete e tyre. "Seminaret e Kontaktave" ndërtojnë partneritete të vërteta mes vendeve MEDA dhe Vendeve të Programit, dhe "Vizitat e shkurtra studimore" paraqesin punën rinore në rajon.


## 2. Përhapja e praktikave pozitive



Qendra Burimore e SALTO-s Euro-Med kryen dhe përhap praktikave e mira të edukimit nëpërmjet

trajnimin dhe punës me rininë për të krijuar një memorje të përbashkët. Ajo:

- Koordinon një "Toolbox" on line që u ofron përdoruesve akses në mjetete e ndryshme të trajnimit dhe dokumentacion: [www.salto-youth.net/toolbox](http://www.salto-youth.net/toolbox)
- Mbledh raportet e kurseve të trajnimeve edukative "Bërja bashkë e të dyja anëve"
- Publikon dy herë në vit revistën: "Meet in EuroMed" (Takohemi në Euromed).
- Organizon çdo vit një panair i cili u jep mundësinë të gjithë aktorëve në fushën e rinisë të shkëmbejnë praktikave dhe të rrisin njohuritë e tyre për mjetet e reja edukative



## 3. Mbështet Rrjetet

Qendra Burimore e SALTO-s Euro-Med mbështet rrjetin e Agjencive

Kombëtare, Njësive rinore të Euro-Med dhe Zhvilluesve të Programit YIA me anë të:

- Shpërndarjes së informacionit mbi çështjet përkatëse nëpërmjet faqes së internetit
- Propagandimin e praktikave të mira edukative në punën rinore nëpërmjet gazetave mbi "Bashkëpunimi Euromed". Gazetat dhe revistat u shpërndahen edhe të gjithë partnerëve institucionalë dhe OJF-ve. Gjithashtu, qendra Burimore e SALTO-s Euromed, u përgjigjet kërkesave të veçanta të

Njësive Rinore EuroMed dhe Agjencive Kombëtare si dhe ofron mundësi për punë praktike.

## 4. Partneritetet

Qendra Burimore e SALTO-s

Euro-Med punon në partneritet të ngushtë me institucione të ndryshme evropiane dhe mesdhetare. Kjo përfshin bashkëpunimin me:

- Qendrat Rinore Evropiane të Këshillit të Evropës, të cilat kanë grupe pune në lidhje me standartet cilësore, vlefshmërinë dhe vlerësueshmërinë e njohurive të fituara gjatë trajnimit: [www.coe.int/T/E/Cultural\\_Cooperation/Youth](http://www.coe.int/T/E/Cultural_Cooperation/Youth)
- Komisionin Evropian dhe Këshillin e Evropës "Trajnimi i liderit të aktiviteteve rinore evropiane" që përfshin dy publikime për rininë dhe trajnimet: "T-Kits" dhe "Coyote" [www.training-youth.net](http://www.training-youth.net)
- Komisionin Evropian dhe Këshillin e Evropës "Bashkëpunimi Euromed në trajnime"
- Platforma rinore Euro - Mesdhetare: [www.euromedp.org](http://www.euromedp.org)
- Fondacioni Euro -Mesdhetar Anna Lindh pwr dialogun ndërmjet kulturave [www.euromedalex.org](http://www.euromedalex.org)
- Njësitë rinore EuroMed: [www.euromedyouth.net](http://www.euromedyouth.net)



Pikëpamjet e pjesëmarrësve: Euromed në një botë apo ide? "E ardhmja" "Mësimi ndërkulturor" "Një zog, që fluturon nga një civilizim në një tjetër. Ai kapërcen kufijtë gjeografikë dhe kulturorë" "Njohja e kulturave të reja, njerëzve. Një botë përtej botës ku ne jetojmë" "Bashkëpunim, zhvillim dhe paqe"





Më shumë informacion rreth programit Youth in Action, mund të gjeni në Guidën e Programit, e cila mund të shkarkohet nga faqja e Komisionit Evropian: <http://ec.europa.eu/youth>. Gjithashtu, Agjensia Ekzekutive e Edukimit, Kulturës dhe mjeteve Audiovizuale, Qendrat Burimore SALTO dhe Agjensitë Kombëtare ofrojnë informacion të mëtejshëm. Detajet e tyre të kontaktit mund t' i gjeni në faqen e programit "youth".

### EUROPEAN COMMISSION

*Directorate-General for Education and Culture – DG EAC*

Unit D2: Youth Programmes

Unit D1: Youth policies

B-1049 Brussels

Tel: +32 2 299 11 11

Fax: +32 2 295 76 33

**E-mail: [eac-youthinaction@ec.europa.eu](mailto:eac-youthinaction@ec.europa.eu)**

**Website: <http://ec.europa.eu/youth>**

*Education, Audiovisual, and Culture Executive Agency – EACEA*

Youth Department

Rue Colonel Bourg 139

B-1140 Brussels

Tel: +32 2 29 97824

Fax: +32 2 29 21330

**E-mail: [youth@ec.europa.eu](mailto:youth@ec.europa.eu)**  
**Webmail: <http://eacea.cec.eu.int>**

### SALTO SOUTH EAST EUROPE RESOURCE CENTRE - SLOVENIA

MOVIT NA MLADINA

Dunajska, 22

SI - 1000 Ljubljana

Tél.: +386-1-430.47.47

Fax: +386-1-430.47.49

E-mail: [see@salto-youth.net](mailto:see@salto-youth.net)

Website: <http://www.salto-youth.net/see/>

### SALTO EASTERN EUROPE & CAUCASUS RESOURCE CENTRE - POLAND

Polish National Agency of the Youth in Action Programme  
Foundation for the development of the Education system  
ul. Mokotowska 43.

PL - 00-551 Warszawa

Tél.: +48-22-622.37.06 / +48-22-628.60.14

Fax: +48-22-622.37.08/ +48-22-621.62.67

E-mail: [eeca@salto-youth.net](mailto:eeca@salto-youth.net)

Website: <http://www.salto-youth.net/eeca/>

### SALTO EUROMED RESOURCE CENTRE - FRANCE

INJEP – Programme Jeunesse en Action

11 rue Paul Leplat

F - 78160 Marly-le-Roi

Tél.: +33 (0)1 39 17 2594/ 2555/ 2755

Fax: +33 (0)1 39 17 2757

E-mail: [euromed@salto-youth.net](mailto:euromed@salto-youth.net)

Website : <http://www.salto-youth.net/euromed/>



REPUBLIKA SLOVENIJA  
MINISTRSTVO ZA ŠOLSTVO IN ŠPORT  
URAD ZA MLADINO

This brochure is an adaptation of the brochure »Paths to International Cooperation in the youth field«, which was published by the SALTO-YOUTH Resource Centres for South East Europe, Eastern Europe & Caucasus and EuroMed in 2007. It is produced and published by:

SALTO-YOUTH SEE Resource Centre  
MOVIT NA MLADINA

*Editor:* Sonja Mitter

*Director of publication:* Janez Škulj

*Translation into Albanian:* Albanian Society in Development (ASD), Tirana

The SALTO SEE Resource Centre cannot be held responsible for the accuracy of the translation.

*Design and Layout:* Madline Communication and Blaž Verbič

*Printed by:* "Siena" shpk